



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 5710/11 prot.

Vlorë, më 24.03.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NË APARTAMENTET E NDËRTUARA NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE NË LAGJEN "KUSHTRIMI", RAJONI NR.5, VLORË. MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT, NIVELIN MINIMAL DHE MAKSIMAL TË TË ARDHURAVE DHE DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË PLOTËSOJNË FAMILJET/INDIVIDËT QË DO TË PËRFITOJNË NGA KY PROGRAM.

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1.1 shkronja b, neni 24, neni 55 pika 6, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social" të ndryshuar, neni 2 pika 7 dhe 44, neni 11 pika c, neni 14, 15, 16, 44, 48, 49, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", të "Marrëveshjes së bashkëpunimit mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, BKU, në Bashkinë Vlorë" të nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Vlorë, me Nr.1632/1prot., datë 10.09.2020 për EKB dhe Nr.7528prot., datë 10.09.2020 për Bashkinë Vlorë, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

VENDOSI

- I.** Të miratojë zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen "Kushtrimi", Rajoni Nr.5, Vlorë;
 - Sistemin e pikëzimit për përzgjedhjen dhe kualifikimin e familjeve/individëve që do të përfitojnë apartament për strehim në këto banesa, sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
 - Nivelin minimal dhe maksimal të të ardhurave që duhet plotësojnë familjet dhe individët, që përfitojnë nga ky program, sipas strukturës së apartamentit që u takon me normat e strehimit. Aneksi nr.2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
 - Dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet dhe individët aplikantë, lista sipas Aneksit 3. bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
- II.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës & Investimeve Publike.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Brunilda Mersini

Miratuar me VKB Nr.87, date 30.10.2023

FORMATI I SISTEMIT TË PIKËZIMIT

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	Totali 25
A	Nuk disponon apartament në pronësi	5
B	Banojnë në banesa rrezik shembje	3
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	3
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore	3
D	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	3
E	Familjet e dëbuara apo të nxjerra forcërisht nga banesat e palegalizuara, për shkak të investimeve publike	8
1.2	KUSHTET FAMILJARE	Totali 25
A	Familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna	5
B	Persona në pension, që nuk janë strehuar në institucionet e përkujdesjes shoqërore.	2
C	Familje me më shumë se katër fëmijë	5
Ç	Familjet e reja	10
D	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	3
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
A	Personat me aftësi ndryshe	2
B	Personat me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror deri në 30 vjeç	3
C	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve	3
Ç	Emigrant i rikthyer, punëtor migrant, azilkërkuesit dhe refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese	1
D	Familje të policëve të rënë në detyrë	3
E	Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë FNSH	1
Ë	Punonjësit e repartit RENE A	1
F	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	1
G	Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit	1
GJ	Anëtarë të komunitetit rom	2
I	Anëtarë të komunitetit egjiptian	2

J	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur, pas ekzekutimit të dënimit	1
K	Vajzat nëna	3
L	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktime për shkak të orientimit seksual, ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent	1
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
A	Familje me të ardhura brenda kufijëve të miratuar	25
B	Familje me të ardhura jashtë kufijëve	0

Dokumentacioni që duhet të paraqesin aplikantët është si vijon:

I. Për të dhënat personale të aplikantit:

1. Çertifikatë e lindjes së aplikantit
2. Vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore

II. Për vërtetimin e kushteve familjare :

1. Çertifikatë familjare
2. Vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijët për çiftet e divorcuara

III. Për vërtetimin e kushteve sociale:

1. Vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara
2. Vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar.
3. Dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë, si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara
4. Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin emigrant, punëtor emigrant, azilkërkues
5. Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e policëve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, etj
6. Urdhër mbrojtje lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje
7. Vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane
8. Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin
9. Vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI
10. Vërtetim me çertifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë

IV. Për vërtetimin e kushteve ekonomike

1. Vërtetim i të ardhurave neto të familjes, me vërtetim nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit dhe të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune
2. Dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes
3. Vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar
4. Vërtetim nga zyra e punësimit të njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë
5. Vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

V. Për vërtetimin e kushteve të strehimit

1. Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes dhe nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi të ka humbur për shkak të një fatkeqësie, ose force madhore.
2. Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja, apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është nën normat e strehimit në fuqi

3. Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që ka ndryshuar vendbanim për efekt punësimi.
4. Akt-verifikimi nga njësia vendore për
 - banesat rrezik shembje
 - rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore
 - banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi legalizimit
 - vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës

Akti i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale, ose struktura, të cilat klasifikohen si banesë.

Tabela me kufijtë e të ardhurave minimalë dhe maksimalë të përcaktuara sipas numrit të personave në familje dhe strukturat përkatëse të apartamenteve që përfitojnë:

Struktura e apartamentit	Struktura e familjes (Numri i personave)	Siperfaqe /m2	Të ardhurat minimale mujore (lekë)	Të ardhurat maksimale vjetore (lekë)	Të ardhurat maksimale mujore (lekë)
Garsoniera	1	47	Paga minimale	537993	44833
1+1	2	64.5	Paga minimale	738310	61526
2+1	3-4	79.93	Paga minimale	914932	76244
3+1	5-6	94.4	Paga minimale	1080565	90047



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5710/11 prot.

Vlorë, më 24.03.2026

RELACION

Për projektvendimin

PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NË APARTAMENTET E NDËRTUARA NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE NË LAGJEN "KUSHTRIMI", RAJONI NR.5, VLORË. MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT, NIVELIN MINIMAL DHE MAKSIMAL TË TË ARDHURAVE DHE DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË PLOTËSOJNË FAMILJET/INDIVIDËT QË DO TË PËRFITOJNË NGA KY PROGRAM.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1.1 shkronja b, neni 24, neni 55 pika 6, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social" të ndryshuar, neni 2 pika 7 dhe 44, neni 11 pika c, neni 14, 15, 16, 44, 48, 49, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", të "Marrëveshjes së bashkëpunimit mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, BKU, në Bashkinë Vlorë" të nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Vlorë, me Nr.1632/1prot., datë 10.09.2020 për EKB dhe Nr.7528prot., datë 10.09.2020 për Bashkinë Vlorë, ju informojmë se:

Sipas marrëveshjes së dytë dypalëshe të nënshkruar midis dy institucioneve sa më sipërcituar, me qëllim zbutjen e problematikave të strehimit të familjeve në nevojë në qytetin e Vlorës, Enti Kombëtar i Banesave gjatë viteve 2020-2024 ka financuar dhe ndërtuar në lagjen "Kushtrimi", Rajoni Nr.5, Vlorë, dy objekte të tjera banimi me kosto të ulët dhe eficientë energjie, me 8 kate (7 kate banimi dhe 1 kat përdhe si ambjente shërbimi) gjithsej 75 apartamente.

Me shkresat Nr.14921prot., datë 15.09.2025 "Kërkesë për vënien në dispozicion të listës së familjeve që përfitojnë strehim në dy banesat e ndërtuara në qytetin e Vlorës" dhe Nr.14921/1prot., datë 17.10.2025 "Kërkesë e përsëritur për vënien në dispozicion të listës së familjeve që përfitojnë strehim në dy banesat e ndërtuara nga EKB në qytetin e Vlorës" Enti Kombëtar i Banesave ka kërkuar nga Bashkia Vlorë miratimin dhe vënien në dispozicion të listës së familjeve që do të përfitojnë strehim në këto apartamente.

Enti Kombëtar i Banesave i sugjeron Bashkisë Vlorë që të miratojë një listë me 75 emra, të ndjekur me një listë rezervë me të paktën 40 emra, ku në miratimin e kësaj liste të evidentohen familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuar, të cilët duhet të kenë përparësi në përzgjedhjen e kateve të banimit.

Tabela orientuese mbi strukturën dhe çmimet e përafërta:

Nr.	Struktura e apartamentit	Çmimet e shitjes së apartamentit	Sipërfaqja/m2	Numri i apartamenteve
1	1+1	2,412,579	63.5	1
2	1+1	2,507,562	66	1
3	1+1	2,431,575	64	20
4	2+1	3,077,463	81	15
5	2+1	2,940,687	77.4	6
6	2+1	3,092,660	81.4	14
7	3+1	3,586,574	94,4	9
8	Garsoniera	1,785,688	47	9
	GJITHSEJ			75

Këto apartamente mund të shiten me këste mujore për 15 vjet me interes 3% në vit, ose me pagesë të menjëhershme, pasi Enti Kombëtar i Banesave e ka të nevojshme vjeljen e të ardhurave në mënyrë të menjëhershme, me qëllim vijim e programit të ndërtimit të banesave me kosto të ulët edhe në qytete të tjera.

Mbështetur në ligjin nr.22/2018, datë 03.05.2018 të ndryshuar, neni 17, 18, 19, në VKM Nr.325, datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale”, në VKB Vlorë Nr.6, datë 31.01.2022, si edhe referuar Vendimit Nr.8, datë 13.03.2026, Komisioni i Strehimit propozon që Bashkia Vlorë të blejë me fondin e akumuluar 20 apartamente si vijon;

-2 apartamente garsonierë me sipërfaqe= 47 m2

-2 apartamente (3+1) me sipërfaqe= 94,4 m2

-6 apartamente (1+1) me sipërfaqe = 66 m2

-10 apartamente (2+1) me sipërfaqe =81,4 m2

Në procedurat e ndarjes për familjet e pastreha do të jenë në dispozicion 55 apartamente, përkatësisht;

-7 apartamente garsonierë

-7 apartamente (3+1)

-16 apartamente (1+1)

-25 apartamente (2+1)

Në funksion të zbatimit të këtij programi mbi parimet dhe kriteret e përcaktuara ligjore, për ti paraprirë njoftimit për fillimin e aplikimeve nga qytetarët e pastrehë mbi kriteret të qarta dhe thellësisht transparente, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 13.03.2026 mori vendim për hartimin e sistemit të pikëzimit, përcaktimit të nivelit maksimal dhe minimal të të ardhurave, që duhet të përmbushin familjet përfituese, përcaktimit të listës së dokumentave që duhet të plotësohet nga aplikantët, si vijon:

1. Bazuar në ligjin 22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar nëni 15, përzgjedhja dhe kualifikimi i familjeve përfituese bëhet nëpërmjet sistemit të pikëzimit, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj dhe kriteret specifike të programit. Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë ka hartuar sistemin e pikëzimit në total me 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16 përmban 25 pikë. Bashkëlidhur këtij projektvendimi është vendosur sistemi i pikëzimit i hartuar për këtë program, sipas Aneksit Nr.1

2. Lidhur me nivelin e të ardhurave që duhet të përmbushin familjet për të përfituar banesë me kosto të ulët, Komisioni i Strehimit i është referuar nenit 48, ku përcaktohet se: përfitojnë banesë me kosto të ulët familje dhe individë me të ardhura vjetore neto baras ose më të ulëta se 1/6 e vlerës mesatare të banesës në treg, sipas Aneksit nr.2 bashkëlidhur. Vlera mesatare e shitblerjes së banesave në treg do të merret në zbatim të Urdhërit Nr.1052, datë 02.12.2024 “Për miratimin e mesatares së çmimeve të shitjes së banesave në treg, sipas zonave kadastrale, për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, të cilat përdoren në kuadër të strehimit social prej 68,680 l/m2.

3. Dokumentacioni që duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë Bashkisë Vlorë aplikantët, familje dhe individë që do të përfitojnë apartamente për strehim është përcaktuar në ligjin nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar dhe në VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, lista sipas Aneksit nr.3 bashkëlidhur.

4. Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve të aplikimit nga ana e qytetarëve, si edhe të procedurave të shqyrtimit dhe të përzgjedhjes nga ana e Bashkisë Vlorë, kjo do të përcaktohet me Urdhër të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

5. Sa më lart, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë projektvendimin e paraqitur, me qëllim kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së listës së familjeve/individëve përfitues të apartamenteve të ndërhuara nga Enti Kombëtar i Banesave.


KRYETAR
Brunilda Mersini



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 5710 prot.

Vlorë, më 24.03 .2026

MIRATOHET
KRYETAR

Brunilda Mersini

VENDIM

Nr. 8, datë 13.03.2026

Për zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave.

Përcaktimin e sistemit të pikëzimit, niveleve të të ardhurave dhe dokumentacionit për familjet dhe individët që do të përfitojnë strehim në këto apartamente.

Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 13.03.2026, në mbështetje të të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 2 pika 7 dhe 44, neni 11 pika c, neni 14, 15, 16, 44, 48, 49, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, të “Marrëveshjes së bashkëpunimit mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, BKU, në Bashkinë Vlorë” të nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Vlorë, me Nr.1632/1prot., datë 10.09.2020 për EKB dhe Nr.7528prot., datë 10.09.2020 për Bashkinë Vlorë, mori në shqyrtim shkresat Nr.14921prot., datë 15.09.2025 “Kërkesë për vënien në dispozicion të listës së familjeve që përfitojnë strehim në dy banesat e ndërtuara në qytetin e Vlorës” dhe Nr.14921/1prot., datë 17.10.2025 “Kërkesë e përsëritur për vënien në dispozicion të listës së familjeve që përfitojnë strehim në dy banesat e ndërtuara nga EKB në qytetin e Vlorës” të Entit Kombëtar i Banesave, ku ka kërkuar nga Bashkia Vlorë miratimin dhe vënien në dispozicion të listës së familjeve që do të përfitojnë strehim në këto apartamente.

Mbështetur në ligjin nr.22/2018, neni 17, 18, 19, në VKM Nr.325, datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale” dhe VKB Vlorë Nr.6, datë 31.01.2022, Bashkia Vlorë do të blejë me fondin e akumuluar 20 apartamente si vijon;

-2 apartamente garsonierë me sipërfaqe= 47 m²,

-2 apartamente (3+1) me sipërfaqe= 94,4 m²

-6 apartamente (1+1) me sipërfaqe = 66 m²

-10 apartamente (2+1) me sipërfaqe =81,4 m²

Në procedurat e ndarjes për familjet e pastreha do të jenë në dispozicion 55 apartamente, përkatësisht;

-7 apartamente garsonierë

-7 apartamente (3+1)

-16 apartamente (1+1)

-25 apartamente (2+1)

Mbas blerjes së 20 apartamenteve nga Bashkia Vlorë me fondin e akumuluar nga 3% mbi subjektet ndërtuese në funksion të krijimit të fondit publik të banesave nga kontributi i sektorit privat, ngelen 55 apartamente që do të shpërndahen për familjet e pastreha.












Komisioni vendosi të përcaktojë sistemin e pikëzimit, nivelet e të ardhurave dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet aplikuese. Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve të aplikimit nga ana e qytetarëve, si edhe të procedurave të shqyrtimit dhe të përzgjedhjes nga ana e Bashkisë Vlorë, kjo do të përcaktohet me Urdhër të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

1. Bazuar në ligjin 22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar neni 15, përzgjedhja dhe kualifikimi i familjeve përfituese bëhet nëpërmjet sistemit të pikëzimit, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj dhe kriteret specifike të programit. Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë hartoi sistemin e pikëzimit në total me 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16 përmban 25 pikë.

2. Lidhur me nivelin e të ardhurave që duhet të përmbushin familjet për të përfituar banesë me kosto të ulët, Komisioni i Strehimit i është referuar nenit 48, ku përcaktohet se: përfitojnë banesë me kosto të ulët familje dhe individë me të ardhura vjetore neto baras ose më të ulëta se 1/6 e vlerës mesatare të banesës në treg. Vlera mesatare e shitblerjes së banesave në treg u mor në zbatim të Urdhërit Nr.1052, datë 02.12.2024 “Për miratimin e mesatares së çmimeve të shitjes së banesave në treg, sipas zonave kadastrale, për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, të cilat përdoren në kuadër të strehimit social prej 68,680 l/m².

3. Dokumentacioni që duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë Bashkisë Vlorë aplikantët, familje dhe individë që do të përfitojnë apartamente për strehim u përcaktua sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar dhe në VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

KOMISIONI:

Irena Toshkallari	Kryetar	
Kristaq Jorgaqi	anëtar	
Mirela Mishgjoni	anëtar	
Skerdilajd Hunda	anëtar	
Orest Ruçaj	anëtar	
Elidon Jaho	anëtar	
Donald Leskaj	anëtar	
Bledar Toja	anëtar	
Genard Fegaj	anëtar	
Kanan Shakaj	anëtar	
Birçe Aliraj	anëtar	
Drini Harizaj	anëtar	
Drita Mustafai	anëtar	